



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.05.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me kryetarin e Entit Rregullator të Energjisë (ERE), zotin Petrit Ahmeti, lidhur me shqyrtimin e raportit vjetor të Entit për vitin 2017. *(Komisioni përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lefter Koka, Lorenc Luka, Gjetan Gjetani, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Petrit Ahmeti – Kryetar i Entit Rregullator të Energjisë

Rajmonda Islamaj – anëtare e Entit Rregullator të Energjisë

Erjola Sadushi – anëtare e Entit Rregullator të Energjisë

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përsëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Ashtu siç jeni në dijëni, sot kemi një seancë dëgjimore me kryetarin e Entit Rregullator të Energjisë Elektrike. Sikundër e përcakton edhe ligji, në një herë në vit dëgjojmë në komisionin tonë parlamentar një raportim të institucionit. Përveç dëgjesave vjetore, kemi pasur edhe një komunikim të vazhdueshëm me Entin.

Personalisht, jam në dijëni të problematikave dhe të nevojave që ka ai institucion. Kjo ka qenë arsyeja pse kemi marrë një iniciativë, bashkë me dy kolegë, me ish-nënkryetarin e komisionit nga Partia Demokratike dhe me një koleg nga Lëvizja Socialiste për Integrim, për të propozuar pranë parlamentit një qasje të re për një institucion, të cilin ne e konsiderojmë shumë të rëndësishëm. Ne jemi në dijëni të përpjekjeve politike për të uzurpuar institucione apo agjenci të ndryshme. Ndërkohë, jemi në dijëni se si ente rregullatore, me rol shumë të rëndësishëm në tregjet që mbulojnë, për shkak të pamundësive e mungesave të kapaciteteve të burimeve njerëzore, të logjistikës, nuk janë në gjendje ta zhvillojnë aktivitetin e tyre siç duhet. Nisur nga këto shqetësime, duke dalë përtej ideologjive apo bindjeve partiake, ne arritëm të bënim një propozim, për të treguar se këto ente kanë nevojë për t'u fuqizuar institucionalisht, kanë nevojë për t'u mbështetur me logjistikë, kanë nevojë për të përthithur burime njerëzore profesionale dhe të afta për të qenë në nivelin e sfidave që kërkojnë institucione të tilla. Fatkeqësisht, Kuvendi nuk e mori në konsideratë. Unë dua të ftoj kolegët, që ne të vijojmë me përpjekjet, jo thjesht për Entin Rregullator të Energjisë, por për të gjitha autoritetet e pavarura, të cilat monitorojnë, ndjekin dhe mbikëqyrin dhe tregje shumë të rëndësishme për ekonominë shqiptare. Ne jemi në dijëni të bjerrjes së këtyre institucioneve nga pikëpamja e kapaciteteve njerëzore, për shkak të konkurrencës. Sot kemi një numër të konsiderueshëm investimesh private, të cilat dita-ditës po tërheqin kapacitete njerëzore, ndërkohë nuk jemi ende në gjendje që t'u ofrojmë kushte më të mira, paga më të mira pune.

E nisa mbledhjen e komisionit me një shqetësim tonin të hershëm, për ta risjellë në vëmendjen e kolegëve të nderuar. Përpjekja vazhdon, do ta vijojmë, nuk do ta bëjmë vetëm për Entin Rregullator, por do ta bëjmë përgjithësisht për institucionet e pavarura rregullatore, duke përfshirë Entin Rregullator të Ujit, Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Sektori i energjisë elektrike është një sektor shumë i rëndësishëm. Personalisht, sapa erdha nga një takim me Komitetin e Energjisë së Vjenës në Bruksel. Patëm një debat shumë të frytshëm edhe në Parlamentin Europian, ku Shqipëria meriton përgëzime. Tani filluam një rrugë të re dhe jemi në prag të disa sfidave jashtëzakonisht të vështira. Pra, nëse deri tani jemi

në rregull, tani e tutje do të matemi me një nivel kërkesash të reja. Ndaj, po e prisnim me padurim raportimin e sotëm, për të mësuar më shumë se çfarë duhet të kemi në vëmendjen tonë, si ligjvënës, për të mbajtur dhe për ta konsoliduar atë që, tashmë, është një histori suksesi, e deklaruar dhe e pranuar edhe nga partnerët tanë. Por që të vazhdojë të jetë e tillë, duhet të jemi në përgjigje të sfidave që paraqet koha. Më duhet t'ju them se sfidat janë shumë të vështira.

Pa humbur kohë, dua t'u jap fjalën kryetarit dhe anëtarëve të bordit, të cilëve u uroj mirëseardhjen në komision! Më pas do të vazhdojmë me pyetjet, me përgjigjet e pyetjeve dhe në fund me kolegët që kanë diskutime. A jeni dakord me rendin e ditës?

Urdhëroni, zoti Ahmeti!

Petrit Ahmeti – Faleminderit, zoti kryetar!

Po e filloj me problematikën që ngritet për Autoritetin e Entit Rregullator dhe për sfidat e tij. Ai është një ent që merret me rregullimin e tregut të energjisë elektrike dhe të gazit natyror në Shqipëri. Kjo është detyra bazë dhe mbi këtë detyrë, ose si objektiv, kemi ndërtimin e një platforme rregullatore për zhvillimin sa më të shpejtë dhe më të thellë të tregut të këtyre dy mallrave që janë mjaft të rëndësishme dhe jetike për ekonominë dhe për vendin tonë.

Më vjen mirë që dëgjova këto fjalë nga ju në lidhje me konsideratat që vijnë nga Komiteti i Energjisë, i cili, aktualisht, është një nga strukturat më të rëndësishme në vendet e Europës Juglindore dhe është një intelokutor mjaft i rëndësishëm midis vendeve të Europës Juglindore dhe Parlamentit European. Pa dashur të zgjatem, qëllimi kryesor është që i gjithë sistemi rregullator, baza legjislative, duhet të jetë në një konformitet me atë të Bashkimit European, ose me direktivat e Bashkimit European.

Kam kënaqësinë të them se të gjitha elementet e legjislacionit sekondar që ne miratojmë me entin rregullator, janë të dakordësuar dhe të konsultuara me Komitetin e Energjisë, i cili natyrisht përfaqëson një strukturë të autorizuar nga Bashkimi European dhe i ngritur apostafat për të krijuar një klimë rregullatore të ngjashme dhe të përshtatshme me direktivat e Bashkimit European.

Nuk dua të zgjatem shumë te kjo temë, pra te raportet që ne kemi me Komitetin e Energjisë, edhe pse është mjaft e rëndësishme dhe më vjen mirë që edhe te ju kanë mbërritur përshëndetjet pozitive. Ne kemi kohë që i kemi marrë, për më tepër që kanë shërbyer për të inspiruar dhe për të përmirësuar më tepër, në kuptimin kualitativ, punën tonë në rregullator.

Enti Rregullator i Energjisë ka një detyrim për të krijuar rregullat e nevojshme në tregun e energjisë elektrike dhe të gazit natyror. Dihet që struktura e sistemit energjetik në

Shqipëri, përbëhet nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare, nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Shpërndarjes. Natyrisht, detyra e Entit Rregullator është promovimi i bazës së legjislacionit sekondar, mbështetur në ligjin primar mbi sektorin e energjisë, për të rregulluar raportet dhe marrëdhëniet midis këtyre dy kompanive. Shkurtimisht, mund të them se edhe gjatë vitit që kaloi, kemi pasur rezultate shumë pozitive, por, përtej rezultatit ose fjalës pozitive, do të thosha rezultate të qëndrueshme, sepse sektori i energjisë ka një veçori shumë të madhe: kërkon një qëndrueshmëri në zhvillimin dhe në ecurinë e tij. Prandaj, dua të them dhe të nënvizoj, edhe pse nuk është një vendim i vitit të kaluar, por është një vendim i viteve të mëparshme, vendimi që mori Enti Rregullator për unifikimin e çmimit të energjisë elektrike lidhur me popullatën. Ky ishte një hap që gjeneroi mjaft elemente pozitive dhe shkëputi përfundimisht problematikën ose përgjegjësinë që ka kompania nga abuzimet, që mund të bëheshin te klientët apo te përdoruesit privatë të energjisë elektrike. Pra, në njëfarë mënyre, iku dhe një element negativ, i cili krijonte problematika qoftë në bilancin, por edhe në buxhetin e kompanisë të shpërndarjes. Ky ishte një element dhe një hap mjaft pozitiv.

Gjithashtu, Enti Rregullator ka ndjekur me shumë vëmendje edhe raportet midis kompanive, marrëdhëniet midis tyre të vendosura mbi bazën e një legjislacioni sekondar, për të respektuar dhe për të pasur si objektivi final marrëdhëniet e çfarëdolloj raporti, që kanë kompanitë midis tyre, te konsumatori final, që është pjesa e popullatës apo konsumatorët e tjerë industrialë.

Këtë vit dua të veçoj jo vetëm thjesht tendencën, por realizimin e hapjes së mëtejshme të tregut të energjisë elektrike. Kryesisht po përqendrohem te elementet mjaft sinjifikative, sepse raporti vjetor, natyrisht, është shumë voluminoz, ka të dhëna sintetike dhe të detajuara në lidhje me aktivitetin e kompanive në veçanti. Por, pse e nënvizoj faktin e liberalizimit të tregut? Jo thjesht se është një direktivë e Bashkimit Europian, sepse direktiva mund të ketë plot, por aplikimi i tyre dhe përshtatja me kushtet është diçka tjetër. Mund të them me kënaqësi që u realizua përfundimisht liberalizimi dhe dalja në treg të lirë e të gjithë konsumatorëve, që janë lidhur me rrjetin 35 kilovolt. Ky fenomen do të vazhdojë edhe për sistemin e shpërndarjes në rrjetin 10, 20 dhe 6 kilovolt. Ky është një hap mjaft i rëndësishëm, i cili, në njëfarë mënyrë, do të identifikojë dhe do të nënvizojë problemet konkrete që do të ketë sistemi i shpërndarjes.

Nga pikëpamja e infrastrukturës teknike për rrjetin 35 kilovolt, kjo është praktikisht e realizuar dhe është bërë funksionale kohët e fundit.

Siguria e furnizimit me energji elektrike është një nga çështjet me rëndësi të madhe dhe krahasimi është shumë i thjeshtë. Në qoftë se para disa vjetësh ne kishim problem për furnizimin me energji elektrike, aktualisht ne po insistojmë, sepse edhe zhvillimi i sektorit është bërë i tillë, që ky mall, i cili quhet energji elektrike, të shkojë në mënyrë kualitative dhe me parametra normalë, sepse, në njëfarë mënyre, po kërkojmë që të vendosim raporte mjaft të drejta ligjore dhe me detyrime të ndërsjella midis konsumatorit dhe kompanive që promovojnë këto shërbime të shitjes së këtij malli, që quhet energji elektrike apo edhe gaz natyror nesër.

Në lidhje me sistemin e shpërndarjes, natyrisht ka shumë gjëra për të thënë, pasi është sistem që kërkon investime shumë të mëdha, kërkon disiplinë teknike, kërkon disiplinë administrative, të cilat kanë qenë edhe në fokusin e punës së Entit Rregullator në të gjithë dokumentacionin që ne kemi miratuar. Në të gjitha vendimet që ne kemi marrë, natyrisht që si objektiv kryesor kemi parë problematikën që kanë konsumatorët, mbrojtjen e tyre, e cila është një nga detyrat bazë dhe primare të Entit Rregullator, por kemi edhe vënien e raporteve të konsumatorit me kompanitë që ofrojnë këto shërbime me bazë sa më të rregullt dhe me detyrime reciproke të mirëfillta, gjë që, për hir të vërtetës, nuk ka qenë kaq e fokusuar më parë. Për zhvillimin e këtij sektori nuk flitet për dy, katër apo për pesë vjetët e fundit, por për një zhvillim në vazhdimësi edhe të Entit Rregullator.

Lidhur me problematikat që kemi hasur me kompanitë, kanë qenë të bazuara për kërkesat për investime dhe për rritjen e shpenzimeve më të mëdha të kompanive. Në analizën tonë të fundit objektivi ynë ka qenë mbrojtja e konsumatorit final, i cili nuk duhet të rëndohet me tarifa me çmime abuzive në tregun e energjisë elektrike.

Për të rritur dhe përmirësuar performancën e sektorit ekzistonte mundësia që të rritej çmimi i energjisë elektrike, por me nivelin e arkëtimeve dhe me përqindjet e arkëtimeve që paguante vetëm një pjesë e popullatë, ishte një vendim, natyrisht, i padrejtë dhe i paarsyetuar. Ne kemi qenë përballë kësaj kërkesë, por më e rëndësishme është performanca e kompanisë në mënyrën më pozitive dhe optimale sesa marrja e vendimit për ndryshimet e çmimit të energjisë elektrike, e cila nuk kishte dimensionë shumë abuzive dhe kjo është e pa pranueshme për politikën e zhvillimit të një vendi, por që do të ishte në fokusin e Entit Rregullator të Energjisë.

Zhvillime mjaft të mira ka pasur edhe në drejtimin e sektorit të gazit natyror. Lidhur me këtë sektor, Entit Rregullator ka detyrimin për miratimin e një pakete të legjisllacionit sekondar, i cili lidhet me raportin që do të kenë kompanitë që merren me tregtimin dhe trajtimin e gazit natyror në Shqipëri. Ne jemi në hapat e parë, sepse edhe vetë strukturat që

ekzistojnë në Shqipëri janë në hapat e parë të konsolidimit, por gjithmonë baza legislative është ajo që udhëheq pjesë të sektorit të gazit apo çdo pjese tjetër të ekonomisë. Kështu që nga kjo pikëpamje, ne kemi ecur me plotësimin e të gjitha kërkesave të ligjit për gazin natyror.

Ne në raport trajtojmë shumë elemente të detajuara, të cilat janë të paracaktuara dhe janë paraqitur në mënyrë të plotë, që informacioni të jetë i tillë, ku çdokush të ketë të drejtën dhe mundësinë të shikojë se çfarë është bërë në këtë sektor. Dua të nënvizoj një fakt, që Enti Rregullator ka përgjegjësinë për koordinimin dhe për trajtimin e aktivitetit të tri kompanive. Natyrisht, çdo kompani punon në mënyrë të veçantë, por ai që i monitoron dhe i harmonizon praktikisht raportet midis tyre është Enti Rregullator. Ky është një mision dhe një detyrë e përcaktuar në ligj, por edhe në detyrat konkrete të të gjitha enteve rregullatorë që ekzistojnë aktualisht.

Një dimension tjetër që dua të nënvizoj është raporti që ne kemi me strukturat rajonale të tregut të energjisë elektrike. Dua t'ju them se ne jemi pjesë e organizmave të vendeve të Europës Juglindore, por njëkohësisht jemi pjesë edhe e organizmave që lidhen me të gjitha vendet e Mesdheut. Në këto organizma ne kemi pozicionet tona, kemi marrë pjesë në mënyrë aktive dhe lidhur me këto organizma ne kemi udhëhequr disa procese, ku kemi marrë edhe vlerësimet pozitive, që nuk dua të ndalem shumë te vlerësimet, por te problematikat dhe detyrimet që ne kemi për të realizuar këto raporte me këto institucione.

Natyrisht, janë bërë shumë hapa të rëndësishëm në lidhje me certifikimin e operatorëve të gazit, që unë i përmenda më parë dhe jemi në diskutimin dhe trajtimin e problematikave që lidhen me tarifat, të cilat janë shumë të rëndësishme në këtë sektor dhe në raportet që kanë vetë kompanitë, të cilat trajtojnë gazin natyror në Shqipëri.

Unë mund të vazhdoj me raportin, ku problematikat janë të shumta, por me mirëkuptimin tuaj, dua të bëjmë një lloj dialogimi lidhur me problematikat, të cilat janë në raportin vjetor. Nëse ka probleme të tjera për t'u nënvizuar, natyrisht ne jemi gati që të bisedojmë dhe t'i përgjigjem interesit tuaj.

Eduard Shalsi – Faleminderit, kryetar!

Mbani shënim pyetjet dhe përgjigjuni pasi të kenë mbaruar të gjithë.

Zoti Baraj, fjala për ju.

Besnik Baraj – Nuk ka asnjë dyshim që ky sektor në vitet e fundit është një model suksesi. Ashtu siç e tha edhe kryetari i komisionit, në këtë sektor është arritur një hap i rëndësishëm. Sfidat që kemi përpara, është një sfidë e madhe. Në gjykimin tuaj, lidhur me uljen e humbjeve, që vijnë për shkaqe teknike dhe shkaqe abuzimesh, a jeni optimist në lidhje

me arritjen e atyre objektivave që parashikohen në këtë drejtim, pra për thellimin e zvogëlimit të humbjeve? Si e gjykoni ju, më shumë është problem në investimin apo në menaxhimin e këtij sektori?

Eduard Shalsi – Zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani- Faleminderit, kryetar!

Shumë faleminderit për prezantimin dhe komplimente për të gjithë punën që ju keni bërë!

Unë kam dy pyetje. Pyetja e parë lidhet me mbrojtjen e konsumatorëve, ku në raport lexova edhe punën e mirë që keni bërë për të adresuar ankesat e konsumatorëve dhe për një leje monitorimi që keni bërë për mënyrën se si janë zgjidhur. Në raport rezulton se ka ankesa nga qytetarët, të cilët nuk kanë marrë ende përgjigje apo nuk janë dërguar në institucionet përkatëse dhe përballen me qytetarë që kanë fatura aforfe apo për të paguar më shumë sesa kanë shpenzuar. Çfarë mund të bëhet që institucioni juaj të jetë akoma më efikas apo të rrisë shkallën e përgjegjësisë për t'i dërguar këto ankesa në institucionet përkatëse, por edhe të monitorimit deri në zgjidhjen e tyre? Si mund t'ju ndihmojmë më shumë ne si komision parlamentar për të kryer detyrën tuaj sa më mirë? A ka ndonjë gjë konkrete që mund të bëjmë ne për punën tuaj, përveç rezolutës që është hartuar?

Eduard Shalsi – Zoti Sinaj, fjala për ju.

Vullnet Sinaj – Çfarë roli ka Enti lidhur me pjesën e investimeve, që do të bëhet në sektorin e shpërndarjes, të rrjeteve, të linjave apo të kabinave elektrike?

Eduard Shalsi – Zoti Baraj, fjala për ju.

Besnik Baraj – Kam edhe një pyetje. Ne kemi miratuar ligjin për energjitë e rinovueshme dhe pretendohet se është një ligj bashkëkohor, i cili i stimulon individët për investimin në nivel familjeje për panelet diellore. Në gjykimin tuaj, cili është roli juaj dhe çfarë mekanizmash duhet të përdoren që kjo të mbajë realisht një peshë të rëndësishme, që familjet të nxiten për ta bërë këtë investim, i cili, në fund të fundit, është për të mirën e familjeve, sigurisht edhe të sektorit për uljen e ngarkesave?

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Baraj!

Zoti Beqaj.

Jemi te pjesa e pyetjeve.

Ilir Beqaj – Ju kërkoi ndjesë nëse nuk kam arritur ta lexoj këtë gjë në raport, por ai është shumë voluminoz dhe i detajuar dhe, ndoshta, i mungojnë përmbledhjet. A ka një vlerësim se sa ka qenë në minuta mesatarja e mosfurnizimit të familjarëve dhe të bizneseve gjatë vitit 2017?

Eduard Shalsi – Kam edhe unë disa pyetje.

A keni raporte, mund të gjykohet edhe nga numri i ankesave, lidhur me energjinë e pamatur? A vijon faturimi aforfe? Si paraqiten të dhënat për vitin 2017? A ka faturim fiktiv dhe mbifaturime? Ju jeni një ent tek i cili drejtohen shpesh edhe konsumatorët. A keni matje jashtë kushteve teknike? Pra, një raport për vitin 2017.

Nga ana tjetër, kemi dëgjuar zëra, edhe ju e përmendët pak në fjalën tuaj, por do të donim të dinim konkretisht: a do të ketë rritje të çmimit të energjisë elektrike?

Gjatë ditëve të fundit është folur, në qoftë se e keni ndjekur nëpër medie, për furrat e bukës. Do të ishte me interes për ne, por edhe për konsumatorët, të dinim diçka më shumë në lidhje me këtë çështje.

Nga ana tjetër, më duhet të them se në vitin 2015, kur kemi miratuar ligjin e energjisë elektrike, kemi qenë të ndërgjegjshëm se vinim nga një situatë në prag humnere. Kur vendosëm disa afate, sigurisht që kishim edhe dyshimet tona nëse ishin afate realiste apo jo. Tre vjet më pas, në vitin 2018, është momenti të bëjmë një bilanc të funksionimit të ligjit. Edhe pse pranuam se janë bërë realisht gjëra të mëdha në sektorin e energjisë, duam të dimë disa afate, të cilave nuk u jeni përmbajtur sipas ligjit të vitit 2015. Ju thashë që ne kemi zhvilluar goxha debat në komision, kemi qenë shumë të përfshirë në hartimin e ligjit, një nga të cilët është furnizimi nga linja 35 kilovolt. I diskutuar dhe i debatuar ka qenë edhe liberalizimi, për të cilin është shtyrë afati, nuk është përmbushur afati. Pra, do të donim një shpjegim, në fakt, i definuar qartë edhe në raportin e Komitetit të Energjisë, me të cilin, në dijeninë tonë, janë zhvilluar disa takime edhe me institucionin tuaj, por edhe me të gjithë aktorët e sektorit në tryezë të rrumbullakët për të bërë një analizë, se ku jemi me afatet, tre vjet pas miratimit të ligjit të energjisë elektrike. A duhet të rishikohet apo të ridiskutohet edhe ndonjë element tjetër?

A do të ketë reduktim tarifash për bazat frigoriferike? Ky është shqetësimi që lidhet me furrat e bukës.

Petrit Ahmeti – Po e nis nga pyetja e fundit, e cila është edhe më sensitivja. Natyrisht, ne nuk kemi planifikuar rritje çmimi për furrat e bukës, sepse, në njëfarë mënyrë, në kohën kur ne vendosëm çmimet për furrat e bukës, ka qenë një mirëkuptim ndërmjet strukturave qeveritare dhe strukturës së Entit Rregullator, duke pasur parasysh që është një aktivitet sensitiv, i cili nuk ka pse të mbajë një peshë, ose mund ta **përballojë**, praktikisht, edhe ndryshimin e çmimit të energjisë elektrike në kuptimin e një mbështetjeje për prodhimin e bukës.

Pa dashur të largohem nga sektori i prodhimit të bukës, të njëjtën gjë mund të them edhe për objektet e kultit. Është po e njëjta logjikë që ne kemi ndjekur, mbi bazën e një kërkesë të të gjithë përfaqësuesve të objekteve të kultit, por, njëkohësisht, edhe një mbështetje nga pala e qeverisë, pavarësisht se ne me qeverinë kemi vetëm një dialog lidhur me politikat e zhvillimit të sektorit, sepse dua gjithmonë të nënvizoj faktin e një pavarësie që ka rregullatori në marrjen e vendimeve. Kështu që edhe këtu është bërë një politikë për reduktimin e çmimit të energjisë elektrike, duke pasur parasysh edhe sensibilitetin që ka në popullatë.

Në lidhje me problemin e zvogëlimit të humbjeve, që u prek fillimisht nga zoti Baraj, mund të them se zvogëlimi i humbjeve ka ardhur në një mënyrë mjaft sinjifikative vitet e fundit. Këtu ndikojnë disa faktorë. Në radhë të parë, është thjesht mobilizimi i kompanisë për reduktimin e këtyre humbjeve dhe për parandalimin e humbjeve teknike, të cilat, natyrisht, njihen teknikisht, sepse ka një nivel të caktuar humbjesh teknike. Këto humbje teknike zvogëlohen jo vetëm me masa administrative, por duan investime mjaft të mëdha. Mund t'ju them se në veçanti sektori i shpërndarjes ka nevojë për investime shumë të mëdha për të zvogëluar humbjet teknike në rrjet.

Nuk dua të shpërndahem në faktorë të tjerë demografikë, sepse edhe zhvillimi i strukturës së një rrjeti inxhinierik ka një bazë teorike, pra ai zhvillohet duke koordinuar jo thjesht rrjetin elektrik, por duke u koordinuar edhe me rrjetet e tjera, me ujësjellës-kanalizimet etj., në mënyrë që të arrihet pika e eficientë. Kjo pikë e eficientë arrihet duke pasur një plan dhe një program urbanizimi shumë optimal të zonës. Por po ju them se, praktikisht, humbjet teknike janë ende në nivele jo të kënaqshme. Unë e theksova edhe më parë që do ta konsideroj një hap shumë pozitiv që ne vijmë me kërkesa më cilësore. Në qoftë se para disa viteve vinim me kërkesën që konsumatorët të furnizohen me energji elektrike, tani themi që jo vetëm të furnizohen, por të furnizohen edhe më një mall, i cili duhet të jetë cilësor. Në vetvete, një nivel i ulët tensioni, po e sintetizoj në kuptimin teknik, është një humbje e madhe edhe e energjisë. Pra, në qoftë se ky nivel tensioni nuk është në kushtet e tij optimale, atëherë do të harxhohet një energji edhe më e madhe për aktivitetin shtëpiak apo industrial që do të nevojitet. Kështu që, nga kjo pikëpamje, dua të nënvizoj se humbjet joteknike varen edhe nga aktiviteti dhe performanca e kompanisë në trajtimin, faturimin, kontrollin dhe moslejimin e vjedhjeve, ndërsa humbjet teknike varen thjesht dhe vetëm nga investimet që do të kryhen në sistem. Pra, është e vështirë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më duhet të flas në pozicionin e inxhinierit. Humbjet teknike në shumë zona janë shumë më të mëdha se humbjet joteknike, të cilat lidhen me faturimin dhe me probleme të tjera. Në zonat të tjera humbjet teknike janë shumë herë më të vogla. Po ju jap një shembull, në kryeqytet para shumë vitesh është realizuar sistemi i shpërndarjes me 20 kilovolt dhe një nga efektet pozitive që pati ishte ulja në mënyrë drastike e humbjeve teknike. Unë kam qenë vetë projektues dhe e di këtë gjë. Humbjet joteknike kanë të bëjnë me performancën e kompanisë. Kjo është një gjë që ne duhet ta kuptojmë dhe duhet t'i ndajmë nga njëra-tjetra. Është tjetër gjë humbja joteknike, e cila vjen për shkak të një disipline të mirë ose të keqe, por që ka pasojat e saj. Humbjet teknike lidhen me cilësinë e rrjetit të energjisë elektrike. Prandaj ky raport është shumë variabël në zona të ndryshme. Diku humbjet teknike janë shumë të mëdha, për të mos thënë që nivelet e tensionit në zonat periferike janë qesharake, prandaj është e domosdoshme kryerja e investimeve dhe fuqizimi i rrjetit. Kjo është një nga rrugët e vetme për të përmirësuar gjendjen dhe zvogëluar humbjet teknike në rrjet. Kompania raporton për humbje në përqindje të bilanceve, por, nëse do të shikojmë grafikët dhe të dhënat, uljet teknike janë shumë të mëdha, pothuajse në gjysmën e niveleve që kanë qenë në vitet e shkuara. Në mënyrë të detajuar ne i kemi paraqitur edhe në raportin vjetor, tani jemi në nivelet 17%, për uljet teknike. Këto janë nivele me trend pozitiv. Vjen një moment që mund të bëhet çdo gjë në lidhje me performancën dhe zvogëlimin e humbjeve joteknike, por janë humbjet joteknike që komprometojnë, pra humbjet në kuptimin e cilësisë së këtij malli, që praktikisht shitet. Unë e theksoj këtë gjë, sepse duhet të kuptohet mjaft mirë që ky mall që quhet “energji elektrike” dhe trajtohet në konceptin tregtar me këto koncepte dhe me këto elemente të trajtimit të një malli të mirëfilltë, është shumë i rëndësishëm dhe është nga mallrat që ka filluar të votohet në bursë. Kjo është shumë e rëndësishme për t’u nënvizuar dhe për t’u parë. Më vjen mirë tani që ne kemi ardhur në hapjen e një kërkese kualitative, nuk e kemi me problematikën për furnizimin me energji elektrike. Ky është një hap shumë i rëndësishëm që unë dua ta nënvizoj.

Në lidhje me ligjin për energjitë e rinovueshme ka hapësirë shumë të gjerë për të diskutuar dhe për të folur, sepse është një koncept mjaft modern dhe i kohëve të fundit, por ka edhe një problem, sepse kostoja e prodhimit fillestar është ende në nivele jo të përshtatshme me çmimet me të cilat operon tregu i energjisë. Më vjen mirë që u mor një vendim qeverie i tillë, që për një fuqi relativisht të pranueshme të jepen licencat për prodhimin me energji diellore, por fuqia të jetë e limituar, sepse, duke qenë një energji, e cila ka një probabilitet të caktuar në prodhimin e vet, ajo e disturbon praktikisht sistemin

energjetik, nuk është një energji që ka një kontinuitet, pra është e vazhdueshme, nëse ka flukse drite, prodhohet, nëse nuk ka flukse drite, nuk prodhohet.

Nga ana teknologjike po prodhohen shumë pajisje, të cilat e depozitojnë këtë energji të prodhuar dhe natyrisht e shesin në një moment të dytë, por, gjithsesi, është një kosto relativisht e konsiderueshme, e cila hap pas hapi do të hyjë në tregun tonë. Ne kemi bërë disa propozime që i janë adresuar qeverisë për të gjitha pajisjet. Unë do të kërkoja një vëmendje ose konsultë që të promovohet ky lloj prodhimi në Shqipëri. Ne jemi një vend që nga 365 ditë të vitit, 300 ditë i kemi me diell, por kjo energji është ende e pashfrytëzuar në mënyrën më të plotë. Teknologjitë në lidhje me tjegullat fundamentaie, panelet dhe faqet e godinave në shumë vende të botës janë të zhvilluara. Natyrisht, këto janë teknologji të reja, që më vonë mund të jenë prezente edhe në vendin tonë.

Në sektorin energjetik ka një ligjësi sipas së cilës i paraprihet me bazë legjislative një zhvillimi teknologjik ose një implementimi të një teknologjie të re. Unë këtë mund të them tani për sistemin fundamentaie, për të cilin ne kemi dhënë disa licenca për prodhimin e energjisë elektrike me diell. Natyrisht, ky është detyrim. Në rastin kur e miratojmë çmimin, atëherë edhe kompania është e detyruar ta blejë këtë energji me çmimin që miratohet nga Enti Rregullator. Kjo është baza legjislative dhe kuadri ligjor mbi të cilat zhvillohen këto aktivitete.

Në lidhje me investimet që kryhen në sektorin energjetik, natyrisht Enti Rregullator ka një rol shumë sinjifikativ, do të thosha, sepse në të gjithë kërkesën që bëhet nga kompanitë për miratimin e tarifave dhe çmimeve ata duhet të justifikohen dhe të paraqesin planin e investimeve të tyre. Madje ne kemi autoritetin që, nëse këto plane investimesh nuk realizohen ose kanë problematikën e tyre, ka kundërveprim nga ana e Entit Rregullator në lidhje me këto lloj mosrealizimesh. Por, gjithsesi, të gjitha planet e investimeve të kompanive, të cilat janë në tregun e rregulluar, paraqiten në Entin Rregullator dhe mbi këtë bazë gjykohet dhe veprohet. Ka raste kur krijohen debate në lidhje me prioritetet e këtyre investimeve, sepse, natyrisht, duhet të jenë të justifikuar. Gjithmonë objektivi ynë finalë është mosngarkesa e konsumatorëve final me elemente të panevojshme, që natyrisht lidhen me shërbimin, kualitetin e shërbimeve që u kryhet atyre, dhe përmirësimin e cilësisë së mallit, që quhet “energji elektrike”.

Do të ndalem në një pyetje në lidhje me sa dhe si mund ta ndihmoni Entin Rregullator. Më vjen mirë që zonja bëri një pyetje të kësaj natyre. Çdo institucion ka nevojë për ndihmë. Ju, zoti kryetar, e nënvizuat që në fillim nevojën e ndihmës së institucioneve të pavarura, ku pavarësia është relative. Pavarësia e Entit Rregullator, së pari, është te pjesa

kualitative, te pjesa e përgatitjes së të gjithë anëtarëve të bordit të komisionerëve. Unë gjej rastin ta shpreh, jam në mes kolegësh me përgatitje dhe përvojë mjaft të mirë, por nuk është vetëm kjo. Enti Rregullator ka përgjegjësi mjaft të mëdha që të monitorojë tregun, të marrë vendime shumë të arsyetuara dhe përgjegjshmëri të lartë.

Nga pikëpamja e efikasitetit dhe e institucionit, unë mund të them se deri tani ne kemi qenë me një ngarkesë shumë të madhe për të përballuar një bazë të legjislacionit sekondar, e cila ka qenë jashtë mundësive të Entit Rregullator. Këtu nuk është për t'u vetëlavdëruar, por gjithsesi ato janë detyrime që rrjedhin edhe nga një pasion për kryerjen e detyrës, por edhe nga një detyrim ligjor, për kryerjen e këtyre detyrave që ne kemi.

Në raport kemi përcaktuar dhe shprehur numrin e vendimeve që kemi marrë gjatë këtij viti, konsulencën që na është dashur të bëjmë, për të cilën kemi marrë ekspertë të fushës, jashtë Entit Rregullator, dhe kemi gjetur dakordësinë mes nesh. Kjo është një temë që lidhet me atë që tha kryetari, me pavarësinë e institucionit, të cilën ne nuk e kuptojmë thjesht si një pavarësi institucionale formale, por pavarësia është e rëndësishme të jetë pavarësi e përgatitjes.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Unë mund t'ju them që ankesat pranë Entit Rregullator janë ulur në mënyrë drastike, sepse, së pari, lidhet me ndryshimin e strukturës së çmimit, e cila krijoi një situatë shumë të konfunduar midis konsumatorëve dhe kompanisë ose, me fjalë të tjera, mund të them që çmimi me dy tarifa e kreu misionin e vet, pa dashur të anatemoj gjërat.

Në lidhje me ankesat, është sistem tabelar, ato janë përgjysmuar, por janë ende më të vogla se vitet e kaluara. Kjo vjen, së pari, nga ndryshimi i strukturës së çmimit, impenjimi dhe angazhimi i kompanisë në lidhje me problematikat e ankesave të qytetarëve. Kohët e fundit kemi një korrespondencë shumë intensive me kompaninë për të kërkuar jo vetëm zgjidhjet e ankesave, por edhe në kohë sa më të shkurtër dhe kam kënaqësinë të them që vërtet ne kemi marrë përgjigje mjaft pozitive. Këto janë elemente, të cilat mund të konfirmohen lehtësisht, pa dashur të hyj në shifra konkrete. Të gjitha janë të paraqitura në raport.

Eduard Shalsi- Meqenëse jemi tek ankesat, a mund t'i përgjigjeni pyetjes për energjinë e pamatur? Pra, a ka ende matje aforfe dhe mbifaturime?

Petrit Ahmeti- Në lidhje me energjinë e pamatur, ka qenë një strukturë, e cila lejonte kompaninë që, në rastet kur nuk kishte matës ose për disa përlllogaritje, të bëhen veprime të kësaj natyre, por kishte një tendencë drejt një mënyre abuzive të faturimit. Ne, si

bord, kemi marrë vendim të mos ketë më fatura aforfe. Pra, është një penalitet, nëse do të konstatohet, por, nëse janë të mbartura nga vitet e kaluara, është tjetër kohë.

Ka edhe një element. Në përgjithësi kompania ka një detyrim për kolaudimin matësve dhe koha e kolaudimit ka të përcaktuar një mënyrë të dhënies së vlerës së faturës, por që është mesatarja e 3 muajve të fundit, vetëm kaq, jo më tepër, sepse këto janë rregulla që nuk janë jo vetëm në kompanitë në Shqipëri, por është një...

Eduard Shalsi – Po ankesa në lidhje me mbifaturimet?

Petrit Ahmeti - Urdhëro?

Ka pasur raste mbifaturimi, të cilat janë ankimuar në Entin Rregullator pastaj janë bërë edhe objekt...

Eduard Shalsi – Si është tendenca krahasuar me një vit më parë?

Petrit Ahmeti – Mund t'ju them diçka, pasi dua ta perifrazoj në mënyrë tjetër, në qoftë se dikur ka qenë një fenomen, tani është një ngjarje e rastit pjesa e trajtimit të këtyre faturimeve në këto forma. Pra, kur them që është një ngjarje e rastit, dikur ka qenë një fenomen jo në kuptimin e keq për të anatemuar diçka, sepse mekanizmi ka qenë i tillë, ndërsa tani po ju them se është një ngjarje e rastit, sepse edhe me kompaninë ne kemi bërë monitorime për këto, si dhe kemi edhe ankesat tona.

(Diskutime pa mikrofon)

Sipas informacionit që kemi, ka përfunduar, megjithëse zakonisht ne bëjmë raportet e monitorimit për të verifikuar, por raportimi është që janë vendosur, ndërkohë që nga kontrolli që kemi ushtruar nuk na rezultuar që në ato vende ku kemi vajtur, të cilat kanë qenë edhe detyrim të kemi gjetur edhe të meta. Kuptohet që kjo është diçka, sepse këto janë fenomene që nuk janë nën kontrollin tonë, por është detyrim ligjor që ata kanë dhe ne thjesht bëjmë kontrollet e monitorimit.

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, për momentin jo.

Në lidhje me çmimin, më vjen mirë që ma adresuat këtë pyetje, sepse është e rëndësishme, logjika ose arsyetimi që në fillim fare kur ne ndryshuam strukturën e çmimit ishte që vetë kompania ose vetë sektori ka nevojë për një qëndrueshmëri disa vjeçare. Në qoftë se do të marrim praktikën e vendeve të zhvilluara, vendimet atje merren për 5-vjeçarin që vjen, ndërsa ne ende jemi te pjesa që marrim vendime për vitin që vjen, por në raport me çmimin kjo ka këtë gjë dhe mua më vjen mirë dhe duhet ta nënvizojë që ka një qëndrueshmëri. Ne nuk kemi presion, por edhe po të ketë presion, ka argumente që e

kundërshtojnë presionin, por në një farë mënyre në këtë situatë nuk kemi presione të kësaj natyre.

(Diskutime pa mikrofon)

Në lidhje me çmimin po ju them diçka dhe këtë e them pa diskutim, siç jua përmenda edhe më parë, në *banch mark*-un e vendeve të rajonit ne jemi të dytët nga fundi në lidhje me nivelin e çmimit, sepse e kam dëgjuar disa herë këtë gjë dhe dua të nënvizoj që vërtet ne jemi vendi i dytë nga fundi në të gjithë vendet e rajonit, ndërsa në çmimin për industrinë jemi në vendet e mesit. Këto janë element konvencional i fundit, i mesit, por jam duke folur...

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, për vendet e BE-së, por jam duke folur për vendet e rajonit, të Ballkanit.

(Diskutime pa mikrofon)

Gjithsesi, nga pikëpamja energjetike jemi vende që kemi të njëjtat problematika, ndaj e bëra këtë krahasim brenda një logjike të caktuar.

(Diskutime pa mikrofon)

Jo ndër më të mbarat, por mund të jetë më i mbari.

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Vazhdojmë me pyetjet e zotit Sinaj.

Petrit Ahmeti – Më falni, zoti Shalsi, por jam i detyruar t'i jap...

Eduard Shalsi – A jemi në rregull me përgjigjet e pyetjeve?

Ju lutem, meqenëse është bërë çështje mbi të cilën ka komente, por ka edhe abuzime, për furrat e bukës është miratuar një tarifë e përgjysmuar. Nga ana tjetër, në dijeninë tonë, ne si komision ende nuk kemi zhvilluar një dëgjësë, por unë do t'u sugjeroja kolegëve të zhvillojmë një dëgjësë me shoqatën, keni zhvilluar një takim me përfaqësuesit. Pra, do të donim të na sqaronit pak më mirë, edhe për dijeni të kolegëve, edhe për shkak të interesit që ka zgjuar, se cili është opinionin juaj pas dëgjësës?

Të nderuar kolegë, ajo që diskutohet është që për furrat e bukës, pasi është miratuar një tarifë e përgjysmuar, por për shkak se brenda furrave të bukës ekzistojnë pajisje si frigoriferë, tarifa është 14 lekë, kërkesa është të përgjysmohet edhe për këtë pjesë. Nga ana tjetër skenari i ndarjes së aktiviteteve, pra veç furrat dhe veç frigoriferët, është pak i komplikuar, prandaj do të donim të dinim që pas dëgjësës që ju keni zhvilluar, a keni ndonjë opinion në lidhje me mënyrën se si duhet menaxhuar kjo kërkesë, nëse jo, a jeni duke e shqyrtuar për të dalë me një sugjerim, koment apo propozim?

Petrit Ahmeti – Zoti kryetar, ne kemi marrë një ankesë dhe kemi bërë një takim me përfaqësuesit e shoqatës së prodhimit të bukës dhe vendimi i Entit Rregullator lidhet vetëm

me subjektet ose strukturat, të cilat prodhojnë bukë. Natyrisht, ka qenë i arsyetuar, siç jua thashë edhe më parë, por me kalimin e kohës është vënë re që këto lokale ose këto ambiente janë shtuar edhe me aktivitet tjetër, nuk dua t'jua listoj tani të gjitha mallrat që shesin, por janë mallra ku nuk është buka praktikisht, ndërkohë pranë tyre është një dyqan, i cili shet po këto mallra dhe çmimi i energjisë elektrike natyrisht është i diferencuar, sepse gjithmonë fshihemi prapa strukturës që çmimit që lidhet me prodhimin e bukës. Në këto raste ka disa sugjerime, por këto sugjerime janë në zgjedhjet e vetë këtyre prodhuesve, ndoshta është pak edhe në sferën që i jep të drejtë edhe prodhuesit, edhe kompanisë. Por kompania nëse sheh që energjia elektrike në këtë pikë shfrytëzohet edhe për aktivitet tjetër ku komshiu e ka çmimin ndryshe natyrisht ky është një konflikt, i cili zgjidhet ose me një investim që ai të ndryshojë dhe ta ketë më vete kontratën për çfarëdolloj pajisje tjetër që ka, përveç furrës së bukës dhe të gjitha pajisjeve që i shërbejnë kësaj gjëje, sepse në fund të fundit krijohet një konflikt. Ne mund t'i biem bilbililit se nuk është ndonjë problem i madh, por gjithsesi kjo është zgjidhja praktikisht në lidhje me këta konsumatorë.

Pra, vendimi i Entit Rregullator është thjesht dhe vetëm për prodhimin e bukës, është çmim për furrat e bukës, por furrë e mirëfilltë buke.

Eduard Shalsi – Faleminderit për përgjigjet!

Petrit Ahmeti – Zoti kryetar, në qoftë se më lejoni, dua të shtoj diçka, pasi e kam merak për problematikat dhe trajtimin e disa elementeve që lidhen jo thjesht me pavarësinë, por edhe me strukturën e Entit Rregullator. Ju e prekët në fillim dhe më vjen mirë që ende është në vëmendje dhe duhet nënvizuar praktikisht jo thjesht një pavarësi abuzive, por një pavarësi institucionale, sepse jemi një institucion që menaxhon tregun e energjisë elektrike dhe në këtë treg midis kompanive natyrisht që ka raporte të caktuara, ka vendime të Entit Rregullator, të cilat në fund të fundit në bazë të tyre kanë ekuilibrimin e interesave të konsumatorëve.

Ne shpesh ndodhemi përpara institucioneve të pavarura të shtetit, të cilave jemi të detyruar t'u japim një përgjigje, t'i respektojmë nga pikëpamja institucionale, por kemi nevojë të konsultohemi, pa dashur të futem në detaje në këtë takim sepse nuk është ky objektivi, të bisedojmë, të dialogojmë, duke parë edhe ecurinë e një mbështetjeje reale që ka pasur ky komision në raport me institucionin tonë, Entin Rregullator të Energjisë dhe të Gazit Natyror.

Ju falënderoj për mirëkuptimin që shprehët, por do të kërkoja që kontakti ynë të jetë edhe më intensiv në vazhdimësi qoftë edhe në mënyrë të veçantë me anëtarët e këtij komisioni të nderuar, natyrisht edhe për trajtimin e problematikave...

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti kryetar!

Fjala për relatorin Beqaj, pasi jemi në pjesën e komenteve.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Së pari, në qoftë se më lejoni, zoti kryetar, si deputet i ri doja të bëja një koment në lidhje me formatin e dokumentit. Do kisha preferuar ta bëja më të thjeshtë leximin, duke mos pretenduar se jemi të gjithë specialistë të fushës të kishite një ekzekutim *summery*, për të lexuar në mënyrë sa më lehtë arrijet kryesore të sistemit apo edhe problemet. Për shembull, në lidhje me pyetjen që bëra nuk mora ndonjë përgjigje, por kjo nuk ka ndonjë rëndësi, sepse besoj se auditi ...

(Diskutime pa mikrofon)

Mbaruan përgjigjet dhe... Pra, auditi është një nga kriteret e rëndësishme se si matet një sistem, aq më shumë me problematikat që kemi ne në Shqipëri. Pra, duhet të kemi parasysh se auditi është një nga elementet që matet edhe kur bëhet raporti *Doing Business* dhe krahasohemi me të gjitha vendet e botës se si të bëhet ekonomi në Shqipëri.

Kam disa pyetje të tjera, të cilat mendoj t'i lë në fund që kur të bëjmë rezolutën t'i kemi parasysh në mënyrë më plotë për të lexuar se çfarë ka ndodhur gjatë vitit, ndërkohë...

(Diskutime pa mikrofon)

... bëhet raporti "*Doing business*" dhe krahasohemi me vendet e botës se si të bëhet ekonomi në Shqipëri. Kam disa pyetje të tjera, që do t'i bëj në fund, në mënyrë që, kur të bëjmë rezolutën, të kemi parasysh për të lexuar në mënyrë më të plotë se çfarë ka ndodhur me vitin, por ndërkohë...

(Diskutim pa mikrofon)

Të gjitha janë të shprehura, por raporti është aq i madh, sa duhet të shkosh të bësh...

(Diskutim pa mikrofon)

Ky është vendi ku raportoni ju. Standardet i krijojmë këtu, pastaj, në qoftë se keni formate të tjera dikur tjetër...

Eduard Shalsi – E mbajtëm shënim, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj - Për shembull, për industrinë, në faqen 71, në mos gaboj, ku janë humbjet sipas çdo rajoni, duhet t'i nxjerrësh vetë në përqindje, sepse nuk dalin sa janë humbjet dhe aritmetikën duhet ta bësh vetë, por do të vijmë edhe tek ajo pjesë.

Në vlerësimin tim, nuk ndaj të njëjtin mendim me ju. Nuk besoj se sektori demonstroi qëndrueshmëri në prodhim dhe nuk realizoi shumë ndihma financiare. Po ua ilustruj thjesht: prodhimi vjet, për arsye të motit, krahasimisht ka qenë nën mesataren e viteve të fundit dhe, në mos gaboj, nëse OSHEE-ja del me një mesatare 2.8-2.9 miliardë lekë humbje, nuk mund

të themi që ky vit për energjinë është përshtatur shumë mirë nga ana financiare. Këto dy momente, të paktën, besoj se janë shumë të rëndësishme.

Ndërkohë, me sa duket, situata do të vazhdojë të jetë problematike, edhe për faktin se vjet prodhimi i privatëve arriti 35.5 dhe mesa duket do të vazhdojë të jetë edhe më i madh, që do të thotë, nga një anë më shumë prodhim privat, nga ana tjetër goxha detyrim që privatit t'ia blejë OSHEE-ja me një çmim që është rënë dakord sipas marrëveshjes. Kjo do të vazhdojë ta vendosë OSHEE-në dhe për pasojë të gjithë sistemin në situatë problematike. Në ndryshim nga cili është merakja juaj, që të mos ketë ngarkesë të re tarifore për konsumatorët, mund të shkojmë atje pashmangshmërisht, dhe, që të mos shkojmë atje, duhet të fillojmë t'i paraprijmë kësaj gjëje. Nga materiali konstatohet, sipas projeksioneve të OST-së, që në vitin 2022 do të kemi nevojë për import në masën 25%.

Jemi vend që bëjmë tregti, eksportojmë dhe importojmë. Për dy vjet kemi qenë neto import, por ajo që më shqetëson është që, nëse jemi neto në njësi energjetike, jemi shumë më keq në vlerë monetare. Ne eksportojmë lirë dhe importojmë shtrenjtë. Mund të jetë edhe kjo e pashmangshme, por aq më shumë me HEC-et e reja, sidomos me këto të voglat, që nuk kanë basene, të cilat prodhojnë kur ka shi dhe dalin në treg, kjo situatë do të vazhdojë të jetë problematike. Nga kjo pikëpamje, ndoshta ju si Ent dhe ne si komision, duhet të krijojmë një vizion se çfarë do të bëjmë 5 vjetët e ardhshëm, të paktën të hidro. Ndërkohë, në faqen 43, kur flisni për eficiencën e prodhimit të energjisë, midis të tjerash, thoni se është kryer optimizimi i prodhimit të import-eksportit në funksion të dokumenteve të energjisë elektrike. Dhjetori i kaluar nuk na rezulton kështu, por ishte një shembull ku ne nuk ishim të zotët të parashikonim, dhe u gjendëm një muaj jashtë mesatares me një situatë problematike.

Në faqen 84, do të doja që të na kishit sjellë informacion edhe për muajin dhjetor, ju konstatooni që KESH-i ka shitur dhe blerë për optimizim portofoli. Ai vërtet është shoqëri tregtare publike me rol specifik dhe neve na intereson i gjithë sistemi, aq më shumë pjesa publike e sistemit. Në qoftë se hetimet e periudhave prill-qershor-tetor janë pozitive, për muajin dhjetor nuk e kam atë informacion. Do të ishte mirë të na e sjellin për të bërë një raport më të plotë. Nuk është problematik i gjithë viti 2017, por situata e periudhës janar-shkurt ka qenë shumë e agravuar. Edhe pse viti 2018 mund të jetë një vit shumë i mirë në gigavat, eksport, prodhim dhe import, tremujori i parë për energjinë në vlerë monetare, në bilancin tregtar, vazhdon të ndikojë shumë më negativisht. Në qoftë se është 1 me 1, në mos gaboj, raporti i mesatares së dekadës së fundit është 0,4, pra në vlerë monetare ne jemi 60 % deficitar edhe kur jemi të balancuar në gigavat. Ndërkohë, është evidente që humbjet joteknike kanë rënë në shifër. Nuk ka më mundësi për të nxjerrë shumën e teknikave shumë

më të mëdha, por këta që merren me këtë punë thonë që për ta ulur një pikë, duhen 50 milionë, të cilat janë para, që, mesa duket, sistemi e ka të vështirë t'i nxjerrë.

Ajo që më shqetësoi ishte një e dhënë, nuk e kam të fiksuar faqen, ju e dini më mirë se cila faqe është, që OSHEE-ja 48,7 % të kabinave i ka vetat, ndërsa 51,3% i ka të privatit. Të gjithë ne ndeshim gjithnjë një fenomen, prishet një kabinë që e ka privati, i cili ka ndërtuar pallatin dhe ka ikur. Në të tilla raste, OSHEE-së nuk i lejohet të shpenzojë, sepse i quhet dëm financiar. Më pas e gjithë situata pasqyrohet te konsumatori dhe, sigurisht, ndikon në mënyrë të padrejtë edhe tek humbjet. Domethënë, të gjitha arritjet shumë të mira të 5 vjetëve të fundit, ku kemi shkuar nga 43% humbje në 26%, ka ardhur momenti që për ta vazhduar të mbajmë këtë ritëm agresiv të përmirësimit të sektorit, ndoshta do të na duhen ndërhyrje shumë më të thella strukturore.

Diskutimi i hapur, është diskutimi i modelit të tregut. Ne kemi pasur një dëgjese me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, por nga ajo dëgjese, të paktën unë personalisht, nuk dola më i qartë nga ç'isha kur filloi biseda. Në fund fare vazhdoi po ajo mjegull, si vendet e tjera e kanë bërë më mirë, etj., por vendet e tjera janë shumë më të mëdha se ne dhe mund ta kenë filluar këtë gjë para 30 vjetësh. Ndërkohë, ne mund të jemi më të matur në angazhimet që kemi për detyrimet ndërkombëtare, sepse, në fund të fundit, bëhet fjalë jo vetëm për një mall shumë jetik për çdo familje, por edhe për një element shumë të rëndësishëm për të bërë biznes në vendin tonë. Ka kërkesa të mëdha për zhvillimin e turizmit në bregdet, për të zhvilluar bujqësinë, por praktikisht, situata e shtrënguar në të cilën ndodhet OSHEE-ja... Ju me të drejtë i mbani penjtë e balonës kur doni të bëni investime aty ku, në radhë të parë ka konsumatorë, por në zonat e mëdha, ku ka perspektivë zhvillimi i vendit... Nga ana tjetër, sigurisht që për distanca të largëta me rrjetin, investimet e privatëve, përveç investimeve të tyre dhe për t'u lidhur me energji, bëhen të pakonsiderueshme.

Ndërkohë, për të punuar për projektrezolutën, 4 apo 5 pyetjet që lidhen me investimet publike, private, fuqinë e rritur të instaluar apo punësimin, do t'ua dërgojmë dhe do t'i marrim gjatë ditëve, në mënyrë që, kur të kemi draft-rezolutën, t'i përcaktojmë mirë arritjet, problematikat, dhe mbas problematikave të mund të projektojmë çfarë detyrash do të na dalin. Nuk e di nëse do të kemi përsëri seancë me ju kur të diskutojmë projektrezolutën, por do të kisha dëshirë, kryetar, që këto dy-tri momente t'i diskutojmë edhe me kolegët për t'i vendosur në projektrezolutë.

Së pari, si do ta zgjidhim pronësinë e kabinave të OSHEE-së, që ajo të ketë të drejtë të ndërhyjë. Mua nuk më intereson pronësia, por e drejta për të ndërhyrë dhe ligjshmëria në bërjen e shpenzimeve financiare te një gjë që nuk e ka të vetën.

Së dyti, me sa di unë, OSHE-ja është në përfundim të vënies në punë të sistemit të faturimit. Besoj se sistemi i faturimit modern, i cili duhet të përfundojë vitin e ardhshëm, duhet ta lehtësojë shumë më tepër mënyrën e matjes së energjisë. Ka vende shumë më të zhvilluara se ne që zbatojnë një mesatare 3-mujore, 6-mujore dhe ti shkon bën leximin. Në projektin e Bankës Botërore po fillon investimi edhe për matësat inteligjentë.

Së treti, ka një mjegullnajë lidhur me humbjet që ka OSHEE-ja prej pikës së lidhjes së heceve të vogla private.

(Diskutim pa mikrofon)

Këtë vit nuk ka ndodhur asgjë, atëherë duhet ta ripërsëritim, sepse aty ka probleme. Nuk ka një vlerësim të plotë, por vetëm thashetheme mund të jetë, kaq, apo aq. Vetvetiu, është normale që, në qoftë se investitori privat nuk ka pasur interes personal, nuk i ka dhënë shumë rëndësi cilësisë së asaj linje, por edhe për të mos e vënë në qafë të askujt.

Pra, këto tri momente do të doja t'i diskutonim në projektrezolutë. Faleminderit!

Eduard Shalsi - Doja të të përgëzoja për propozimet, por edhe për leximin e vëmendshëm të raportit!

Gjithsesi, duhet mbajtur shënim që duhet një sinopsis i raportit me gjetjet kryesore të vitit. Jo të gjithë deputetët kanë mundësinë për ta lexuar dhe absorbuar. Nuk pretendojmë që jemi edhe ekspertë energjie, kështu që mbajeni shënim si sugjerim. Për mua qëndron.

Duke falënderuar të gjithë kolegët dhe kryetarin bashkë me ekipin e tij, ne do të përgatisim një draft të rezolutës, të cilin do t'ua shpërndajmë deputetëve për komente, sugjerime ose vërejte. Do të vijojmë të jemi në kontakt.

Këshilltarët të mbajnë shënim, në vijim të vizitave që bëjmë në institucione të ndryshme, gjej rastin të falënderoj deputetët për vizitën që bëmë në AZHBR dhe të inkurajoj të tjerët për të ardhur në vizitat e ardhshme, sepse është një mënyrë shumë e mirë për të kuptuar institucionin nga brenda. Në axhendë do të vendosim një vizitë te mjediset e Entit Rregullator të Energjisë.

Faleminderit dhe mirë u takofshim!

MBYLLET MBLEDHJA